



**MJAFT!**

**SONDAZH I OPINIONIT PUBLIK  
mbi 100 Ditet e para te Qeverisjes  
PERMBLEDHJE E REZULTATEVE  
KRYESORE**

**1 Shkurt 2006**

*Shënim:* Ky sondazh është kryer nga Index Albania, bazuar në standartet ICC/ESOMAR. Kampioni i përdorur është statistikisht i mjaftueshëm për të përfaqësuar opinionet e shoqërisë Shqiptare. Të dhënat e paraqitura në këtë përmbledhje nuk pasqyrojnë detyrimisht qëndrimet e Lëvizjes MJAFT!, apo donatorëve të saj.

## HYRJE

Sondazhet e opinionit publik rreth çështjeve të ndryshme të prekshme për shoqërinë shqiptare janë një hap përpara në konsolidimin e demokracisë në vend. Në të njëjtën kohë, zhvillimi gjithmonë e më i shpeshtë i tyre, dëshmon rritjen e cilësisë së komunikimit politik në vend dhe emancipimin e klasës sonë politike.

Ndërkohë që votimet në zgjedhje apo referendume, përvec se japin qëndrimin e votuesve rreth çështjeve kryesore, mandatojnë një parti politike apo një kandidat të caktuar, sondazhet dhe anketimet japin ndjesinë e opinionit publik rreth tematikës për të cilën anketohet. Në këtë mënyrë, politikbërësit marrin informacion të vlefshëm në lidhje me gjërat që po shkojnë mirë, çështjet të cilave u duhet kushtuar më shumë vëmendje apo politikat që kanë nevojë për ndryshim.

Ky sondazh i porositur nga Lëvizja MJAFT! është kryer nga **“Index Albania“**, kompania shqiptare me eksperiencën më të gjatë në fushën e mbledhjes së opinionit publik, një kompani e asociuar me **Taylor Nelson Sofres (TNS)**, një ndër kompanitë lider në fushën informacionit në mbarë botën.

Sondazhi synon të mbledhë opinionin e qytetarëve për mbarëvajtjen e gjërave në vend gjatë 100 ditëshit të parë të qeverisë së re.

### **Metodologjia**

Ky sondazh është kryer gjatë periudhës 11-22 janar me intesitet më të lartë gjatë datave 14-17. Janë intervistuar 1000 individë në të gjithë vendin dhe secila intervistë zgjati 20-25 minuta. Intervistat u kryen, ballë për ballë me letër dhe laps në vëndndodhjen e të intervistuarit. U përdor metoda e probabilitetit të rastësishëm në disa faza. Intervistimi u bë në 124 pika vëzhgimi në të gjithë territorin e Shqipërisë. Rezultatet e anketës kanë një kufi gabimi statistikor prej  $\pm 2.6\%$ .

***Ky sondazh u bë i mundur falë mbështetjes të Balkan Trust for Democracy. Të dhënat e paraqitura në këtë përmbledhje nuk pasqyrojnë detyrimisht qëndrimet e Lëvizjes MJAFT! apo të donatorëve të saj.***

## REZULTATE KRYESORE

### Drejtimi kryesor i gjërave në vend

Qytetarët shqiptarë duken të ndarë në tre grupime të mëdha përsa i përket ndjeshmërisë së tyre në lidhje me ecurinë e gjërave në vend. Grupi më i madh i të intervistuarve (45.3%) nuk janë të vendosur nëse gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur apo të gabuar. Mes atyre që kanë një opinion të vendosur ka një epërsi të lehtë të qytetarëve që mendojnë se gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur (27.8%) nga ata që mendojnë se gjërat po shkojnë në drejtimin e gabuar (25.8%).

Ndërkohë, rreth 43% e të anketuarve i shohin me shpresë veprimet e qeverisë në raport me situatën në vend, përkundrajt 39% të cilët i shohin me dyshim dhe 15% të cilët shprehen të zhgënjyer.

### Vlerësimi për 100 ditët e para të qeverisë

Qytetarët e Shqipërisë, për 100 ditët e para i kanë dhënë Qeverisë një notë mesatare **6.3**, në një shkallë nga 4 (dështim) në 10 (sukses). Të pyetur se si ka ndikuar qeverisja aktuale brenda 4 muajve të fundit, tek ata personalisht, si dhe në jetën, në punën e tyre, në familjen, te të afërmit dhe në komunitetin ku ata jetojnë, 81.1 nuk ndjejnë ndonjë ndryshim të dukshëm, ndërkohë që rreth 9.2% ndjejnë se ka ndikuar për keq, përkundrajt 8,6% që ndjejnë se ka ndikuar për mirë.

### Krahasimi me periudhën para 3 korrikut

Të intervistuarve iu kërkua të vlerësojnë ecurinë, në muajt e fundit, të një sërë çështjeve, krahasuar me periudhën përpara 3 korrikut. Shumica e të intervistuarvë, në pothuajse të gjitha çështjet mendojnë se ecuria ka qenë e njëjtë. Sidoqoftë qytetarët mendojnë se në: Hapjen/transparencën e pushtetarëve ndaj publikut, medias e shoqërisë civile; Luftën kundër korrupsionit, Reformën fiskale, tatimet e taksat si dhe; Reformën në arsim, në këto muaj të fundit ka pasur një ecuri më të mirë krahasuar me përpara 3 Korrikut

Ndërkohë që për; Zbutjen e varfërisë; Respektimin e ndarjes së pushteteve; Shërbimet shëndetësore; Respektimin e autonomisë së pushtetit lokal dhe; Qëndrimin ndaj opozitës ecuria gjykohet si më e keqe krahasuar me periudhën përpara 3 korrikut.

### Notat për ministrat qeverisë

Të intervistuarve iu kërkua të vlerësojnë me nota nga 4 (Të dështuar) deri në 10 (Të suksesshëm), secilin nga ministrat e qeverisë, përfshi dhe kryeministrin.

Tre ministrat me notë më të lartë janë Genc Pollo me (6.9) ndjekur nga Genc Ruli e Besnik Mustafaj (6.8). Ministrat me notë më të dobët janë Lufter Xhuveli (5.6) Koco Barka (6) dhe Arenca Troshani e Jemin Gjana(6.1)

### **Cështje specifike**

Pjesa më e madhe e qytetarëve, rreth 57%, kanë vlerësuar si të drejtë, zvogëlimin e disa ministrive dhe dikastereve dhe ristrukturimin e administrates, përkundrejt 39% të cilët e gjykojnë si të padrejtë apo të gabuar. Rreth 55% gjykojnë se shkurtime në administratë janë të padrejta dhe të gabuara përkundrejt 41% të cilët besojnë se ato janë të drejta.

Reforma fiskale dhe ulja e taksave për biznesin e vogël gjithashtu vlerësohet si e drejtë nga rreth 71% e të intervistuarve përkundrejt 20% të cilët e gjykojnë si të padrejtë apo të gabuar.

Konflikti me Bashkinë e Tiranës për cështjen e “Zogut të Zi” vlerësohet si i padrejtë apo i gabuar nga rreth 67% e të intervistuarve, përkundrejt 26% të cilët e gjykojnë si të drejtë qëndrimin e qeverisë.

### **Besueshmëria**

Qytetarët shqiptarë vazhdojnë të tregojnë një besueshmëri më të lartë ndaj institucioneve ndërkombëtare (NATO 67, BE 65, OSBE 62). Ndërsa, institucionet kombëtare më të besuara rezultojnë Media (56) dhe Presidenti i Republikës (53). Ndërkohë që institucionet më nivelin më të ulët të besimit të publikut janë Qeveria (41), Prokuroria (35) dhe Gjyqësori (32).

---

Për cdo informacion të mëtejshëm rreth këtij sondazhi kontaktoni me:

**Sagita Muço**

[sagitamuco@mjaft.org](mailto:sagitamuco@mjaft.org)


+355 68 20 59489

Lëvizja MJAFT!


Rr. Elbasanit Nr. 77

Tiranë


**Nisur nga shkalla juaj e njohjes, ne pergjithesi punet ne Shqiperi jane duke ecur ne drejtimin e duhur apo ne drejtim te gabuar?**




**Duke gjykuar ne pergjithesi rreth gjendjes ne vend, veprimet e Qeverise se re i shihni me shprese, me dyshim apo jeni i/e zhgenjyer?**




**Duke e krahasuar situaten e tanishme politike ne Shqiperi me periudhen para Zgjedhjeve te 3 korrikut, a mendoni se situata e tanishme eshte me e qete, me e tensionuar apo me kritike?**



**Duke e krahasuar situaten e tanishme ekonomike ne Shqiperi me periudhen para Zgjedhjeve te 3 korrikut, a mendoni se situata e tanishme eshte shume me e mire, disi me e mire, disi me e keqe apo shume me e keqe?**




**Brenda ketyre 4 muajve, tek ju personalisht/ne jeten e punen tuaj/te familjes e te afermve/te komunitetit ku jetoni, ne c'menyre kane ndikuar efektet e qeverisjes aktuale?**




Duke i krahasuar me periudhen para 3 Korrikut 2005, mendoni se gjate muajve te fundit eshte ecur e po ecet Me mire, Njelloj apo Me keq ne lidhje me:


Lufta kunder Korrupsionit




Reforma Fiskale, Tatimet, Taksat



Transparenca e Pushtetareve ndaj Publikut, Medias dhe Shoqerise Civile








Reforma ne Arsim




SONDAZHI I 100 DITEVE – MJAFT!  
DEPARTAMENTI I POLITIKAVE

Duke i krahasuar me periudhen para 3 Korrikut 2005, mendoni se gjate muajve te fundit eshte ecur e po ecet Me mire, Njelloj apo Me keq ne lidhje me:




**Me cfare note do ta vleresonit veprimtarine e Qeverise gjate 100 diteve te para?**

## Nota per veprimtarine e Kabinetit Berisha nga 4 - 10




Gjate muajve te pare Qeverisja aktuale po synon te vere ne jete nje sere nismash e ceshtjesh te rendesishme. Duke i referuar disa prej ketyre nismave, te permendura me poshte, a e vleresoni Shume te drejte, Disi te Drejte, Disi te Padrejte apo Krejt te Gabuar menyren se si po i trajton keto ceshtje Qeveria aktuale.


Zvogelimi i disa ministrive dhe dikastereve dhe ristrukturimet ne administrate




Shkurtime ne Administrate



Reforma ne Sistemin e Drejtesise




Projekt Buxheti 2006




Gjate muajve te pare Qeverisja aktuale po synon te vere ne jete nje sere nismash e ceshtjesh te rendesishme. Duke i referuar disa prej ketyre nismave, te permendura me poshte, a e vleresoni Shume te drejte, Disi te Drejte, Disi te Padrejte apo Krejt te Gabuar menyren se si po i trajton keto ceshtje Qeveria aktuale.



Reforma Fiskale, ulja e taksave per biznesin e vogel




Problemet e pagave/pensioneve




Konflikti me Bashkine e Tiranes per rregullsi e nje sere punimesh urbane (Zogu i Zi, et)




## Sa iu besoni institucioneve te meposhteme?



## Vleresimi per Politikanet



**Si i parashikoni 4 vitet ne vijim te Qeverise aktuale: Shume te suksesshme, Disi te suksesshme, Disi te pasuksesshme apo Krejt te pasuksesshme?**



### Si i karakterizoni muajt e pare te veprimtarise se Edi Rames si Kryetar i PS?

